

Komunikimi Jo i Dhunshëm (KJV)

Tipi i Programit: Plotësues

Historiku i Programit

Ideja e zhvillimit të këtij programi ka filluar pas zhvillimit të shumë programeve të trajnimit për mësimdhënës duke e parë të nevojshëm përmirësimin e komunikimit në klasa/ shkolla ndërmjet aktorëve të shkollës që nga viti 2014, kur u jetësuan shumë programe trajnimi në kuadër të USAID e të GIZ. Analizimi i situatave të ndryshme në shkolla u bë inspirim që të kërkohen programe të certifikuar për Udhëheqje e Menaxhim, të cilat kishin temë bosht Komunikimin Jo Të Dhunshëm. Pas certifikimit nga Europass Teacher Academy (Firencë – Itali) me titull “Leadership and Management for School Principals” me temë bosht “Non Violent Communication”, bazuar në teorinë e Marshall Rosenberg, në kuadër të Center for Non Violent Communication – CNVC (Austin, Texas, SHBA) u zhvilluan konceptet e programit, dhe u diskutuan me aktorë kryesorë të arsimit. Në muajin nëntor të këtij viti (2023) dokumenti u pilotua nga KEC gjatë zhvillimit profesional me bazë në shkollë të stafit të shkollës “Mileniumi i Tretë”. Për shkak të rëndësisë që ky program ka në zhvillimin e plotë të kompetencës kryesore kurrikulare, dhe si rrjedhojë e përkushtimit shtesë për zbatimin e komunikimit efektiv në shkolla, mësimdhënësit pjesëmarrës kërkuar që ky material të përgatitet si program i veçantë për zhvillim profesional, përmes të cilit fitohen pikë shtesë për licencimin e tyre.

Aplikimi për aprovim të këtij programi bëhet për herë të parë.

Qëllimet e programit:

Është në natyrën njerëzore të kënaqen duke dhënë dhe duke marrë me mirëkuptim (dhembshuri). Megjithatë, kemi mësuar shumë forma të komunikimit që na tjetërsojnë jetën, që na shtojnë të flasim dhe të sillemi në mënyra që dëmtojnë të tjerët, por edhe veten tonë. Një formë e komunikimit tjetërsues/ gjykues është përdorimi i gjykimeve moraliste që nënkuptojnë gabime ose të këqija nga ana e atyre që nuk veprojnë në harmoni me vlerat tona. Një tjetër element që shpesh përdoret është krahasimi, i cili mund të bllokojë mirëkuptimin si për të tjerët, ashtu edhe për veten tonë. Komunikimi gjykues errëson gjithashtu vetëdijen tonë duke qenë se secili nga ne jemi përgjegjës për mendimet, ndjenjat dhe veprimet tona. Komunikimi i dëshirave tona në formën e urdhrat është një tjetër karakteristikë e gjuhës që bllokton mirëkuptimin.

Programi ka për qëllim zhvillimin e shkathtësisë së komunikimit duke i ndihmuar së pari mësimdhënësit të bëjnë atë që tashmë dinë të bëjnë. Po ashtu, inkurajonë individët të shprehin nevojat dhe ndjenjat e tyre në mënyrë jo kërcënuese, duke nxitur marrëdhënie të shëndetshme dhe duke i zgjidhur konfliktet në mënyrë paqësore.

Materiali i këtij trajnimi përmban edhe video-dokumentarin, respektivisht pjesë nga punëtorja e Marshall Rosenberg, ekspertiza dhe shembujt e përgjigjet e drejtpërdrejta të së cilit ndihmojnë shumë në të kuptuarit e thellë të komunikimit jo të dhunshëm. Gjithashtu, materiali i përgatitur në disa fletë pune, sprovon të menduarit e secilit pjesëmarrës duke reflektuar e riformuluar shembullin e tyre

personal, si ndihmesë për promovimin e komunikimit me mirëkuptim e dhembshuri në praktikën e tyre personale e profesionale.

Të gjitha këto elemente të trajnimit do të ndikojnë pozitivisht edhe në vetë performancën e mësimit në klasë/ shkollë.

Pjesëmarrësit në këtë program trajnues do të arrijnë rezultatet si në vijim:

- Identifikojnë rëndësinë e zhvillimit të shkathtësive së komunikimit, personale dhe të nxënësve;
- Vëzhgojnë situatat gjatë komunikimit pa gjykuar dhe pa vlerësuar;
- Analizojnë katër komponentë kryesorë në procesin e komunikimit Gjirafë si: vëzhgimin, ndjenjat, nevojat dhe kërkesat;
- Dallojnë gjuhën Xhakal gjatë analizimit të shembujve të kontekstit shkollor;
- Zbatojnë shembuj të gjuhës Gjirafë kundrejt gjuhës Xhakal;
- Riformulojnë mënyrën e të shprehurit përmes dëgjimit në mënyrë aktive dhe parashtimit të kërkesave për bashkëbiseduesin nisur nga shembujt personalë pa përdorur urdhra;
- Vlerësojnë në ekip karakteristikat e gjuhës Gjirafë që ndihmojnë shmangien e konflikteve të cilat rrjedhin nga komunikimi Xhakal.

Përmbajtja:

Programi i këtij trajnimi përmban pakon e pasur me materiale të larmishme në funksion të përgatitjes sa më të mirë të pjesëmarrësve, me theks të mësimit në klasë e të drejtorëve për promovimin e komunikimit jo të dhunshëm në shkollë. E ashtuquajtura Gjuha Gjirafë apo Gjuha për Jetën (Language For Life) ndihmon në reflektimin e individit për përmirësimin e komunikimit efektiv dhe të respektueshëm me theks në ndjeshmëri, dëgjim aktiv dhe mirëkuptim, përmes së cilës të gjithë aktorët e shkollës do të ngritin kompetencën e komunikimit dhe do t'i kontribuojnë jetës më të lumtur në shkollë. Edhe pse programi përqendrohet në punën me mësimit në klasë e drejtorë/ zëvendës-drejtorë të arsimit parauniversitar, materiali është i përshtatshëm dhe mund të përdoret mjaft mirë edhe me aktorë të tjerë të shkollës dhe me mësimit universitarë, si përkrahje për përmirësimin e komunikimit edhe në atë nivel arsimi.

Prioritet i programit është një ndër kompetencat themelore siç është ajo e të shprehurit dhe komunikimit, dhe e cila përcillet nga disa shkathtësi si: *shkathtësia e të folurit të rrjedhshëm e të saktë, e të dëgjuarit aktiv, e të menduarit kritik e kreativ, inteligjenca emocionale, ndërgjegjshmëria, dhe ajo e zgjidhjes së problemeve*, që do të ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e mësimit në klasë për kontekste të ndryshme kohore dhe vendore duke ndikuar së shumti edhe në zhvillimin e këtyre komponentëve të nxënësve.

Grupi i synuar:

Sipas Kompetencave kryesore të Kornizës së Kurrikulës së Kosovës për arsimin parauniversitar (kompetencës kryesore të komunikimit) e në përputhje me shkathtësitë e shekullit XXI, të gjithë

punonjësit e arsimit, respektivisht të gjithë mësimitdhënësit, drejtorët e administratorët, shërbyesit e këshillimit, nxënësit e prindërit do të duhej të kenë njohuri për përmirësimin e komunikimit jo të dhunshëm i cili promovon komunikim efektiv dhe të respektueshëm me theks në ndjeshmëri, dëgjim aktiv dhe mirëkuptim, në çdo rreth, çdo situatë, dhe me të gjithë.

Synimi i programit është përfshirja e të gjithë aktorëve të shkollës (menaxhmenti i lartë, menaxhmenti i mesëm, mësimitdhënësit, administratorët, shërbyesit e këshillimit, nxënësit dhe prindërit), si temë e rëndësishme për të gjithë e me theks për mësimitdhënësit si personat me më shumë ndikim në jetën e shkollës, të cilët janë në shërbim në arsimin parauniversitar, si dhe me mundësi zgjerimi edhe për mësimitdhënësit universitarë.

Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Programi i trajnimit “Komunikim jo i Dhunshëm” i ka 20 orë të trajnimit të cilat ofrohen përmes trajnimit 2-ditor (16 orë trajnimi) me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë dhe koha e angazhimit për përmbushjen e detyrave që lidhen me rezultatet e programit të trajnimit (4 orë trajnimi). Trajnimi 2-ditor ka gjithsej 8 sesione. Secili sesion zgjatë 90 minuta, plus 4 orë të kalkuluara për vëzhgim në vendin e punës (orë mësimore, takime diskutimi, punë me palë) dhe për takime reflektuese/planifikuese dhe zbatim të komponentëve të komunikimit jo të dhunshëm).

Kursi është i dizajnuar ashtu që të mund të ofrohet në sallë trajnimi ose virtualisht nga distanca përmes platformave elektronike. Kjo përfshin ligjërim, demonstrim, bashkëpunim, realizim me nxënës, me prindër, me kolegë të tjerë në shkollë, prezantime, diskutime, punë individuale, dhe punë në grup me kolegët tjerë mësimitdhënësit. Tërë procesi i trajnimit shtrihet në afat kohor prej 2-3 javësh. Gjatë kësaj periudhe pjesëmarrësit do të mentorohen përmes komunikimit elektronik nga fasilituesit e programit, që të përkrahen në përmbushjen e kërkesave për certifikim.

Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit: mësimitdhënësit/ drejtorët (apo edhe palët e propozuara) do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 20 orë trajnimi (8 sesione x 90 min = 16 orë kontaktuese; plus 4 orë të kalkuluara për vëzhgim në vendin e punës (orë mësimore, takime diskutimi, punë me palë) dhe për takime reflektuese/planifikuese dhe zbatim të komponentëve të komunikimit jo të dhunshëm).

Kriteret për certifikim janë:

- Së paku 90% pjesëmarrje në sesionet kontaktuese dhe në takimet reflektuese me fasilitues;
- Realizimi i Gjuhës Gjirafë në vendin e punës;
- Prezantimi i raportit të praktikimit të komunikimit efektiv në vendin e punës, me palët e interesit.

Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues së bashku me fletët e punës;
- Power Point prezantimi;
- Video prezantimi i Marshall Rosenberg;
- Shembujt e kontekstit shkollor për të dyja gjuhët përmes katër komponentëve të KJV;
- Maskotat (Xhakali dhe Gjirafa);
- Flipchart, markerë, fletë të bardha.